

## Abstrakti

Ballkani Perëndimor përfaqëson një rajon biogeografikisht të larmishëm me një histori komplekse të shkëmbimit faunistik, megjithatë fauna e arahnideve të këtij rajoni mbetet relativisht e pa-eksploruar. Në këtë studim u shqyrtuan karakteristikat faunistike të dy rendeve të arahnideve, Opiliones dhe Araneae, në disa habitate të përzgjedhura të rajonit. Hulumtimi ynë rezultoi me dokumentimin si të specieve të raportuara më herët, ashtu edhe të disa regjistrimeve të reja për zonën e studimit, duke pasuruar kështu njohuritë ekzistuese mbi biodiversitetin rajonal. Gjithsej janë gjashtë gjetje të reja nga rendi Opiliones: *Egaenus convexus* (për Maqedoninë e Veriut) *Mitopus morio*, *Lacinius horridus*, *Opilio parietinus*, *Phalangium opilio*, dhe *Zacheus crista* (për Kosovë), ndërsa nga rendi Aranea një gjetje e re: *Gonatium hilare* (për Kosovë). Për Opiliones, gjetjet ofrojnë të dhëna të përditësuara të shpërndarjes dhe evidentohen lloje që nuk ishin evidentuar më parë. Në mënyrë të ngjashme, fauna e mbledhur e merimangave (Araneae) përfshiu një kombinim specimesh tashmë të njohura dhe evidentime të reja, duke theksuar heterogjenitetin dhe rëndësinë ekologjike të këtyre grupeve. Rezultatet kontribuojnë në një kuptim më të plotë të diversitetit të arahnideve në Ballkanin Perëndimor dhe theksojnë nevojën për vazhdimin e hulumtimeve faunistike dhe taksonomike në këtë rajon të rëndësishëm.

Fjalët kyçe: merimangat, Opilionet, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut.

## Abstract

The Western Balkan represents a biogeographically diverse region with a complex history of faunal exchange and yet its arachnid fauna remains underexplored. In this study, we investigated the faunistic characteristics of two arachnid orders, Opiliones and Araneae, across selected habitats in the region. Our investigation resulted in the documentation of both previously reported species and several new records for the study area, thereby enriching the current knowledge of regional biodiversity. In total, there are six new records from the order Opiliones: *Egaenus convexus* (for North Macedonia), *Mitopus morio*, *Lacinius horridus*, *Opilio parietinus*, *Phalangium opilio*, and *Zacheus crista* (for Kosovo), while from the order *Araneae* there is one new record: *Gonatium hilare* (for Kosovo). For Opiliones, the findings provide updated distributional data and highlight taxa that had not been previously noted in local inventories. Similarly, the collected spider fauna (*Araneae*) yielded a combination of known and newly recorded species, underlining the heterogeneity and ecological significance of these assemblages. The results contribute to a more comprehensive understanding of the arachnid diversity in the Western Balkans and emphasize the need for continued faunistic and taxonomic research in this important region.

Key words: spiders, harvestmen, Kosovo, Albania, North Macedonia.